



Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Në çështjen gjyqësore të *Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit dhe Rexhep Selimit* për krime lufte dhe krime kundër njerëzimit, më 19 mars, Trupi Gjykses miratoi një kërkesë të Prokurorisë dhe autorizoi një dëshmitar të jepte dëshmi në gjykim nëpërmjet videokonferencës. Megjithatë, Trupi Gjykses urdhëroi Prokurorinë të jepte informacion faktik shtesë në lidhje me dëshmitarin.

Më 26 mars, Trupi Gjykses hodhi poshtë një kërkesë të përbashkët të ekipeve të mbrojtjes që t'u lejohet apelimi i një vendimi të Trupit Gjykses që palët t'i dorëzojnë dosjet gjyqësore përfundimtare të tyre në të njëjtën kohë, më datën që e cakton Trupi Gjykses, e jo njëra pas tjetrës. Trupi Gjykses konstatoi se Rregullorja e Procedurës dhe e Provave përcakton se dosjet gjyqësore përfundimtare duhet të dorëzohen në të njëjtën kohë dhe ishte i mendimit se aspektet ballafaqese të procesit nuk kërkojnë që ato të dorëzohen njëra pas tjetrës. Trupi Gjykses vuri në dukje se qëllimi kryesor i dosjeve gjyqësore përfundimtare është që secila palë të paraqesë argumentet e veta bazuar në provat në dokumentacionin e procesit gjyqësor dhe theksoi se secila palë do të ketë mundësinë të paraqesë argumentet e veta dhe t'u përgjigjet argumenteve të palës kundërshtarë gjatë parashtrimeve gojore përfundimtare.

Gjatë kësaj jave, në këtë çështje gjyqësore dhanë dëshmi dy dëshmitarë. Sipas përmbledhjes së Prokurorisë, dëshmitari i parë, z. Maloku, kishte pozita të ndryshme në UÇK gjatë periudhës relevante, ndër të cilat edhe në Drejtorinë Operative të Shtabit të Përgjithshëm. Dëshmitari i dytë dëshmon me videolidhje dhe nën masa mbrojtëse. E tërë dëshmia pritët të jepet në seancë të mbyllur.

Deri më sot, 125 dëshmitarë kanë dhënë dëshmi në këtë çështje gjyqësore.

Seanca e ardhshme në këtë çështje është caktuar për të martën, 1 prill, duke filluar në orën 9 paradite.

Në çështjen gjyqësore *Prokurorja e Specializuar k. Hashim Thaçit, Bashkim Smakajt, Isni Kilajt, Fadil Fazliut dhe Hajredin Kuçit*, si dhe në çështjen gjyqësore të *Sabit Januzit, Ismet Bahtijarit dhe Haxhi Shalës*, gjatë javës së kaluar u bënë publike disa vendime në lidhje me masa hetimore të posaçme, përfshirë operacione të kontrollimit dhe sekuestrimit nga Prokuroria.

Më 21 dhe 22 mars, Trupi Gjykses dhe Gjykatësja e Procedurës Paraprake udhëzuan Zyrën Administrative të Dhomave të Specializuara të organizonte një vizitë të z. Thaçi në Kosovë, që ai të vizitonte varrin e babait dhe të takonte familjen e ngushtë. Z. Thaçi ishte gjatë gjithë kohës nën ruajtje të Dhomave të Specializuara. Kjo





ishte vizita e 14-të nën ruajtje për arsye humanitare bindëse që kanë urdhëruar gjykatësit e Dhomave të Specializuara.

Pas dorëzimit të dosjes së apelit prej z. Pjetër Shala kundër Urdhrit për Zhdëmtim në çështjen e tij, Paneli i Apelit më 27 mars miratoi kërkesën e mbrojtësit të viktimave për zgjatje të afatit për përgjigjen e mbrojtësit të viktimave ndaj dosjes së apelit deri më 4 prill 2025. Paneli rikujtoi se procedura e apelit në këtë çështje është e para në Dhomat e Specializuara në lidhje me një urdhër për zhdëmtim dhe rrjedhimisht mund të jetë precedent i rëndësishëm.

Në lajme të tjera, gjatë kësaj jave përfaqësues të DHSK-së u takuan në Hagë me disa OJQ nga Kosova dhe rajoni për të diskutuar se si të mbahet publiku në Kosovë plotësisht i informuar në lidhje me Dhomat e Specializuara, si dhe pyetjet që mund të kenë njerëzit në këtë fazë të proceseve gjyqësore.

